

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 26.07.2024*

**26.07.2024
Ora 12:10**

RENDI I DITËS

Projektvendim: “Për miratimin e rezultatit të shortit për përcaktimin e renditjes së kandidatëve për Kryetar Bashkie në fletën e votimit, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 gusht 2024”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

- **Z. Ilirjan Celibashi,** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
- **Stafi KQZ:** Znj. M. Koja, znj. P. Doçaj, z. E. Meta.
- Parti Politike:** S’ka prezent!
- Të tjerë:** KRIIK

Z. I. Celibashi: Mirëdita! Atëherë, në seancën e sotme publike kemi dy çështje në rendin e ditës, shortin për caktimin e radhës të renditjes së kandidatëve për Kryetar të Bashkisë Himarë në fletën e votimit, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar, të kësaj bashkie, të datës 4 gusht 2024 dhe një projektvendim “Për caktimin e vendndodhjes së një qendre votimi në një ambient privat”. Mirë, fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës, që ka të bëjë me shortin. Dy fjalë për procedurat e shortit... dhe pastaj Sara, për të zhvilluar shortin.

Znj. P. Doçaj: Po, faleminderit! Me vendimin nr. 8, datë 23.02.2023 të Komisionit Rregullator, ka përcaktuar procedurën e shortit, për renditjen e kandidatëve për kryetar të njësisë së qeverisjes vendore. Procedura do të zhvillohet si më poshtë: Janë përgatitur shiritat e letrës, së barabartë me numrin e kandidatëve të regjistruar për kryetar të bashkisë. Në secilin prej shiritave janë shënuar emrat e kandidatëve

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 26.07.2024*

për kryetar. Është siguruar numri i goglave, i barabartë me numrin e shiritave. Në secilin prej goglave do të futet një shirit letre dhe goglat futen në një enë transparente. Goglat përzihen me qëllim, sigurimin e barazisë në përzgjedhje. Nëpunësi i administratës tërheq nga ena një gogël, e hap, nxjerr shiritin e letrës dhe lexon emrin e kandidatit të shënuar në të. Emri i kandidatit që lexohet në shiritin e parë që tërhiqet do të mbajë numrin 1, në fletën e votimit dhe emri i kandidatit që shënohet në shiritin e dytë që tërhiqet do të mbajë numrin 2, në fletën e votimit.

Z. I. Celibashi: Të dy kandidatët janë regjistruar, kemi një kandidat të regjistruar nga...

Znj. P. Doçaj: Nga Koalicioni “Bashkë Fitojmë”.

Z. I. Celibashi: ...nga “Partia Socialiste” dhe kandidati tjetër nga koalicioni “Bashkë Fitojmë”. Mirë, atëherë lexojmë emrat e kandidatëve.

Znj. P. Doçaj: Po, Vangjel Llambi Tavo “Partia Socialiste e Shqipërisë”. Petraq Epaminonda Gjiguria, propozuar nga Koalicioni “Bashkë Fitojmë”. Pas tërheqjes rezultojnë që:

Emri i parë është Vangjel Llambi Tavo dhe emri i dytë është Petraq Epaminonda Gjiguria.

Z. I. Celibashi: Mirë!

Vendimi nr. 133

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 26.07.2024*

**26.07.2024
Ora 12:12**

RENDI I DITËS

Projektvendim: “Për caktimin e vendndodhjes së një qendre votimi në ndërtesë private për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 gusht 2024”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

- **Z. Ilirjan Celibashi,** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
- **Stafi KQZ:** Znj. M. Koja, znj. P. Doçaj, z. E. Meta.
- Parti Politike:** S’ka prezent!
- Të tjerë:** KRIIK

Z. I. Celibashi: Mirë, atëherë kalojmë te pika e dytë e rendit të ditës.

Z. E. Meta: Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, me datë 16.07 është administruar shkresa, dërguar nga Kryetari në detyrë i Bashkisë Himarë me propozimet për shtatë qendra votimi, për t’u caktuar në ndërtesa private. Komisioneri me vendimin nr. 128, datë 25.07 miratoi caktimin e pesë qendrave të votimit në ambiente private, nga shtatë propozimet e paraqitura. Sa i takon dy qendrave të votimit, përkatësisht qendrave 4562 dhe 4562/01, në fshatin Shën Vasil, njësia administrative Lukovë. KQZ-ë bazuar dhe në kërkesën e KZAZ-së, kreu një inspektim lidhur me kriteret dhe kushtet e propozuara nga Bashkia Himarë për vendndodhjen e këtyre qendrave të votimit. Nga inspektimi në terren u konstatua se ambienti i propozuar nga Bashkia Himarë nuk plotësonte kushtet për të siguruar fshehtësinë e votës. Me datë 25.07 në

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 26.07.2024*

KQZ është administruar propozimi në mënyrë elektronike nga Kryetari në detyrë i Bashkisë Himarë për vendosjen e një qendre votimi në ndërtesë private dhe një në ambient publik. Referuar nenit 62, Kryetari i Bashkisë ka kompetencën për të caktuar vendndodhjen e qendrave të votimit në ambiente publike, ndërsa në referim të nenit 93 të Kodit Zgjedhor, KQZ ka kompetencën të caktojë vendndodhjen e qendrave të votimit në ambiente private. Në kushtet kur Bashkia Himarë ka caktuar vendndodhjen e qendrës së votimit 4562/01 në ambient publik dhe ka ofruar alternativë për qendrën e votimit 4562/00 në ambient privat të fshatit Shën Vasil, lokali i shtetasit Elsa Gjapo. Pas inspektimit në terren nga KQZ vlerësohet se ky propozim i ri i Bashkisë Himarë është në përputhje me kërkesat e nenit 93 të Kodit Zgjedhor si dhe udhëzimit 1 të vitit 2020 të Komisionit Rregullator. Për sa më sipër, bashkëlidhur është projektvendimi për shqyrtim dhe miratim.

Z. I. Celibashi: Mirë, atëherë miratojmë kërkesën “Për caktimin e vendndodhjes së qendrës së votimit nr. 4562 në ambientin privat” sipas lidhjes bashkëlidhur këtij vendimi. Çështje tjetër nuk kemi. Mirë, seanca mbyllet. Faleminderit dhe ditë të mbarë!

Vendimi nr. 132

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

